

# Fleta faktike e të drejtave të lindjes

# Fleta faktike e të drejtave të lindjes

---

Fletët faktike të Birthrights japin informacione për të drejtat tuaja të njeriut kur jeni shtatzënë dhe do të lindni.

Kjo fletë faktike shpjegon të drejtat tuaja themelore për kujdesin e lehonisë. Ne kemi fleta faktike të tjera të disponueshme në anglisht në faqen tonë të internetit: [www.birthrights.org.uk](http://www.birthrights.org.uk)

---

## 1. Ju keni të drejtë të trajtoheni me dinjitet dhe respekt në çdo kohë.

Ligji për të drejtat e njeriut do të thotë që organizatat publike si spitalet duhet t'ju trajtojnë me dinjitet dhe respekt.

Profesionistët e shëndetit (mjekët dhe mamitë) duhet të jenë të sjellshëm dhe të respektueshëm ndaj jush.

Ata duhet t'ju mbështesin për të marrë vendime në lidhje me kujdesin tuaj.

Ata nuk duhet të bëjnë supozime për ju ose për çfarë kujdesi ju nevojitet.

Profesionistët tuaj të kujdesit shëndetësor duhet të sigurohen që të keni një përkthyes nëse keni nevojë për atë, në mënyrë që ju të mund të merrni vendime për kujdesin tuaj.

Ju duhet të keni privatësi kur keni nevojë për të, për shembull gjatë lindjes ose nëse jeni duke ushqyer me gji dhe nuk duhet të ndiheni të ekspozuar ose të pambrojtur.

Nëse keni nevoja të veçanta, për shembull, nëse dëshironi të shihni vetëm profesioniste femra të kujdesit shëndetësor, atëherë kjo duhet të respektohet nëse është e mundur. Nëse kjo nuk është e mundur - për shembull, ju doni lehtësim të dhimbjes gjatë lindjes dhe ka vetëm mjekë meshkuj në dispozicion - atëherë duhet t'ju jepet informacioni që ju nevojitet për të vendosur se çfarë të bëni.

Nëse keni një paaftësi ose gjendje shëndetësore afatgjatë, profesionistët tuaj të kujdesit shëndetësor duhet të sigurohen që të keni qasje të barabartë në kujdes dhe të mos jeni në disavantazh. Kjo mund të nënkuptojë që ju të merrni kujdes ndryshe ose shtesë apo t'ju sigurojë mbështetjen që ju nevojitet (për shembull, të keni qasje në një tualet për persona me aftësi të kufizuara, të keni mbështetje shtesë pasi të keni lindur fëmijën tuaj ose planifikoni të jeni diku sa më qetë nëse zhurma ju shqetëson).

---

## 2. Ju gjithmonë keni të drejtë të thoni jo.

Kur jeni shtatzënë keni të drejtë të merrni vendimet tuaja për trupin tuaj, ashtu si bëni në çdo kohë tjetër.

Profesionistët e shëndetit duhet t'ju pyesin nëse jeni dakord për ndonjë trajtim mjekësor. Për shembull, ata duhet t'ju pyesin para se t'ju ekzaminojnë, para se të matin presionin tuaj të gjakut dhe para se t'ju japin ilaç qetësues. Ky është ligji.

Është në kundërshtim me ligjin që t'ju jepet trajtim mjekësor nëse nuk jeni dakord me të.

Është gjithmonë në rregull të thuash jo. Kjo quhet mosdhënie e pëlqimit.

Nëse dëshironi trajtim dhe thoni po, kjo quhet dhënie e pëlqimit.

Ju mund të kërkonti më shumë kohë për të marrë vendimin tuaj nëse keni nevojë për këtë.

Edhe nëse jepni pëlqimin, mund të ndryshoni mendim.

Edhe nëse profesionistët e shëndetit nuk pajtohen me vendimet tuaja për trupin tuaj, ata duhet t'i respektojnë ato.

Në përputhje me ligjin, pëlqimi juaj duhet të jetë i vërtetë. Kjo do të thotë që ju duhet ta kuptoni trajtimin mjaft mirë për të marrë një vendim. Duhet t'ju jepet informacion në një formë që ju mund të kuptoni dhe informacion në lidhje me rreziqet dhe përfitimet që janë të rëndësishme për ju.

Askush, duke përfshirë familjen tuaj ose profesionistët e kujdesit shëndetësor nuk duhet të ushtrojë presion ndaj jush ose t'ju ngacmojë që të bini dakord për ndonjë trajtim. Ju nuk mund të referoheni te shërbimet sociale vetëm për shkak të vendimeve që merrni në lidhje me lindjen tuaj.

Në përputhje me ligjin, një foshnjë nuk ka të drejta derisa të lindë. Kjo do të thotë që gjatë shtatzënisë dhe lindjes nuk mund t'ju jepet trajtim nëse nuk jeni dakord edhe nëse profesionistët e kujdesit shëndetësor mendojnë se trajtimi është i nevojshëm për foshnjën tuaj të palindur. Jeni të lirë të bëni zgjedhje në kundërshtim me këshillat mjekësore.

E vetmja herë që njerëzit e tjerë mund të marrin vendime për ju është nëse ju mungon aftësia mendore për të marrë një vendim. Kjo ndodh shumë rrallë. Kur kjo të ndodhë, të tjerët (për shembull, mjekët tuaj) duhet të ndjekin proceset ligjore sipas Ligjit të Kapacitetit Mendor (Mental Capacity Act) për të marrë vendimin “më të mirë për ju”.

---

### **3. Kur kërkonti kujdes, shërbimet e maternitetit duhet të thonë “Po” dhe të thonë “Jo” vetëm nëse kanë ndonjë arsye të fortë.**

Nëse dëshironi të përdorni një shërbim, ofruesi i maternitetit duhet të fillojë të thotë “Po”. Duhet të bëjnë çmos për të përmbushur kërkesën tuaj.

Gjatë kujdesit ndaj jush, ju keni të drejtë të bëni zgjedhjet që janë të përshtatshme për ju. Për shembull, ju keni të drejtë të zgjidhni se ku do të lindni. Ju mund të zgjidhni të lindni në një spital, në shtëpi ose në një qendër lindjeje (një njësi e maternitetit që drejtohet nga mamitë). Ju duhet të jeni në gjendje të merrni një prerje cezariene nëse dëshironi.

Ndonjëherë ka kufizime në të drejtat tuaja për të bërë zgjedhje të caktuara. Për shembull, qendrat e lindjes mund të kenë rregulla që thonë se kush mund t'i përdorë

ato ose spitalet mund të kenë rregulla se kush mund të bëjë lindje në ujë. Këto nuk janë rregulla ligjore.

Kur ju bëni një kërkesë për një shërbim të maternitetit, ata duhet të përpiqen të bëjnë atë që ju dëshironi. Ata duhet të thonë “Jo” vetëm nëse nuk mund t'ju japin në mënyrë të sigurt kujdesin që dëshironi.

Ata duhet të marrin një vendim bazuar në situatën tuaj personale dhe t'ju shpjegojnë juve arsyet.

Ata nuk mund të thonë thjesht që politika ose rregullat e tyre thonë “Jo”.

Ka disa zgjedhje që ju gjithmonë mund të bëni. Për shembull, nëse doni të lindni në shtëpi, askush nuk mund t'ju detyrojë të shkoni në spital. Është gjithashtu e ligjshme të lindni pa ndihmë nga mamitë ose mjekët.

Nëse nuk po dëgjoheni ose zgjedhjet tuaja nuk po respektohen, mund të kërkonti të flisni me kryemaminë (Head of Midwifery). Ju gjithashtu mund të kontaktoni Birthrights për këshillë duke dërguar email te: [advice@birthrights.org.uk](mailto:advice@birthrights.org.uk).



#### **4. Ju keni të drejtë që të gjitha nevojat tuaja bazike të plotësohen.**

Nëse jeni në spital, duhet të keni mundësi të përdorni të gjitha gjërat bazike që ju nevojiten, për shembull, ushqim, ujë, ilaçe për dhimbjet dhe mbështetje për të shkuar në tualet.

Ju duhet të dëgjoheni dhe të merreni seriozisht kur kërkonti ndihmë ose kujdes.

Nëse kërkonti ilaçe qetësuese të dhimbjeve gjatë lindjes, duhet t'ju jepen nëse nuk ka ndonjë arsye të mirë mjekësore për të refuzuar. Nëse ka, mjeku ose mamia duhet t'ju shpjegojnë arsyen dhe të regjistrojnë bashkëbisedimin tuaj.

Nëse nuk jeni duke u dëgjuar mund të kërkonti të flisni me kryemaminë ose mjekun në detyrë.



#### **5. Ju keni të drejtë të mbështeteni dhe të jeni së bashku si familje.**

Të drejtat e njeriut ju japin të drejtën të zgjidhni se ku dhe si të lindni dhe kush të jetë me ju.

Ju duhet të jeni në gjendje të zgjidhni se kush të jetë me ju gjatë lindjes. Spitalet dhe qendrat e lindjes mund të kenë politika që thonë se sa njerëz mund të jenë me ju dhe zakonisht nuk lejojnë që fëmijët të qëndrojnë me ju. Këto janë politika spitalore por nuk janë rregulla ligjore. Ju mund të flisni me maminë tuaj ose të kërkonti të flisni me një kryemami nëse jeni e shqetësuar.

Ju mund t'i tregoni mamisë tuaj nëse është dikush që nuk dëshironi të shihni gjatë lindjes ose pasi të keni lindur fëmijën tuaj.

---

## 6. Ju keni të drejtë të ankoheni.

Ju keni të drejtë të trajtoheni me dinjitet dhe respekt në çdo kohë gjatë kujdesit tuaj. Nëse jeni të shqetësuar për kujdesin tuaj gjatë shtatzënisë, mund të flisni me maminë ose mjekun tuaj ose me kryemaminë (Head of Midwifery) në Trustin (Trust) tuaj.

Nëse nuk jeni e kënaqur me përgjigjen ose nëse mendoni se nuk jeni trajtuar me dinjitet dhe respekt, mund të bëni një ankesë. Është në rregull të bëni një ankesë edhe nëse mendoni se ajo që ju ka ndodhur ishte e vogël ose nuk është bërë ndonjë dëm serioz.

Ekipi Shërbimi i Këshillimit dhe Ndërlidhjes së Pacientit (Patient Advice and Liaison Service, PALS) në spitalin tuaj mund t'ju ndihmojë të bëni një ankesë.

Nëse nuk jeni të kënaqur me përgjigjen, mund ta dërgoni ankesën tuaj tek Avokati i Popullit (Ombudsman).

Birthrights gjithashtu ofron këshilla falas mbi të drejtat tuaja dhe për të bërë një ankesë. Ju mund të kontaktoni Birthrights duke dërguar email tek: [advice@birthrights.org.uk](mailto:advice@birthrights.org.uk).

---

## 7. Ju gjithmonë keni të drejtë të merrni kujdes.

Personat që janë “banorë rezidentë” në MB kanë të drejtën e kujdesit falas për NHS. Nëse nuk jeni “banor rezident”, mund të duhet të paguani për kujdesin tuaj.

Edhe nëse duhet të paguani për kujdesin dhe nuk keni mundësi të paguani, përsëri duhet t'ju jepet kujdesi në maternitet. Nuk mund t'ju thuhet se duhet të prisni derisa të mund të paguani.

Rregullat rreth çështjes se kush duhet të paguajë dhe se si funksionon tarifimi janë shumë të komplikuar. Nëse shqetësoheni nëse do të duhet të paguani për kujdesin tuaj në maternitet, shoqata bamirëse Aksioni i Maternitetit (Maternity Action) mund t'ju ndihmojë. Ata ofrojnë informacion në internet. Ata gjithashtu ofrojnë një shërbim këshillimi nëpërmjet emailit dhe [shërbim falas të këshillimit telefonik](#) përfshirë interpretimin nëpërmjet telefonit.

*Mospranim përgjegjësie: Faqet tona me fakte japin informacion për ligjet në MB. Informacioni është i saktë në kohën e shkrimit (maj 2021). Ligji në këtë zonë mund të pësojë ndryshime. Birthrights nuk mund të vihet para përgjegjësive nëse ndryshimet në ligj vijnë pas këtij botimi. Birthrights nuk pranon asnjë përgjegjësi për humbje që mund të ndodhin nga mbështetja në informacionet e përmbajtura në këtë faqe me fakte. Birthrights ka vënë në dispozicion lidhje të faqeve interneti të palëve të treta ku këto mund të ndihmojnë për dhënie informacioni të mëtejshëm përkatës. Birthrights nuk mban asnjë përgjegjësi për përmbajtjen e faqeve të internetit të lidhura dhe lidhjet nuk duhen marrë si miratim zyrtar.*